

Nr.-186/3-.prot

Durrës,më:11/02/2022

### URDHËR

"PËR PEZULLIMIN TE MASE SEKUESTRO KONSERVATIVE"

Drejtuar :QENDRA KOMBETARE BISNESIT TIRANE

**Per dijeni:Debitori:**Shoqeria: "EMS - ALBANIAN PORT OPERATOR"(EMS APO) Sh.p.k. NIPT L31804506A  
Adr;Porti Detar- Terminali Lindor,Hyrja Nr.5 DURRES

**Per dijeni: Kreditori:** Shoqeria:: "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY "Sh.p.k. NIPT K92128501U  
Adr:Porti Detar DURRES

Prane Studio Ligjore te Përmbaruesit Gjyqësor privat Eduard Allamani,bazuar në kërkesen e pales kreditore eshte transferuar per ekzekutim "titullit ekzekutiv" te vendimit gjyqësor11-2018-1229/397,date.13/03/2018 te Gjykates Rrethit Gjyqësor Durres, lene ne fuqi me disa ndryshime me vendimin gjyqësor Nr.10-2020-477/156 date.14/04/2020 te Gjykates Apelit Durres,eshte rregjistruar ceshtja me pale:

**-Kreditor:** SHOQ: "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY" SH.P.K.

**-Debitor:** SHOQ: "EMS - ALBANIAN PORT OPERATOR"(EMS APO)"SH.P.K.

**-Objekti:** Permbushje detyrimi, dorezim sendesh dhe pagim shume;

Une Permbaruesi Gjyqësor Eduard Allamani, pasi studiova aktet ne dosjen permbarimore:

### KONSTATOVA

Ne baze te vendimi gjyqësor te cituar me lart, nder te tjera eshte vendosur: --Lenien ne fuqi te vendimit gjyqësor11-2018-1229/397,date.13/03/2018 te Gjykates Rrethit Gjyqësor Durres persa i perket:

Pranimi te padise per kerkimin e detyrimit te pales se paditur te ktheje automjetet, mankinerite e pajisjet.

Rrezimit te padise per kekrimin,'Detyrimin e te paditurit ti shperbleje paditesit demin per humbjen,demtimin ose pamundesine e kthimit te sendeve te ndodhura gjate kohes se posedimit te tij".

Ndryshimin e vendimit si me poshte:

Detyrimin e pales se paditur Shoqeria:"EMS - Albanian Port Operator"(EMS APO)"Sh.p.k., qe ti paguajc paditesit Shoqeria: Albanian Stevedoring Company" Sh.p.k.,fitimin e munguar ne shumen 15,498,963 leke dhe prej dates 26/09/2017, fitimin e munguar ne shumen 16,091 leke, deri ne vendosjen e pajisjeve ne posedimin e pales paditese..

-Rrezimin e kerkimit per pagimin e amortizimit te paisjeve ne shumen 40,846,976 leke dhe amortizimin ditor ne shumen 19,479 leke/dite deri ne ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si te pa bazuar.

Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga Sherbimi Permbarimor.

- Ne ekzekutim te titullit ekzekutiv te sipercituar pala kreditore ka bere kerkese prane Zyres Permbarimit Gjyqësor Privat BEST 2010 Saimir Hoxha dhe nga kjo e fundit kjo dosje permbarimore eshte transferuar me Vendim Nr.41 Extra, dt.05/02/2021 nga Zyra Permbarimit Gjyqësor BEST 2010 Saimir Hoxha per te Zyra Permbaruesit Gjyqësor Privat Eduard Allamani .

Ne ekzekutim te titullit ekzekutiv,jane kryer disa veprime, ne mbështetje te nenit 519 e vijues te K.Pr.Civile,duke kaluar ne veprime procedurale ligjore, per sekuestrimin e pasurive te pales debitore, persa përcakton ligji, ne rastin konkret sipas akteve ne dosjen permbarimore me Urdher Nr.41/4 Prot,dt.01/06/2020 Zyra Permabimore Best 2010-Permbaruesi gjyqësor Saimir Hoxha ka urdheruar Q.K.Bisnesit Tirane, te bllokoni aset/aksione te debitorit Shoqeria: "EMS -Albanian Port Operator"(EMS APO) Sh.p.k. NIPT L31804506A.

Pala debitore perfaqesuar nga Studio Ligjore PETANI Sh.p.k.sot me dt.11/02/2022 ka paraqitur kerkcscn dt.10/02/2022 dhe bashkngjitur vendimin gjyqësor Nr.12,dt.08/02/2022 te Gjykates Rrethit Gjyqësor Durres, ku nder te tjera ka vendosur:

Pranimin e kerkeses per marrjen e mases sigurimit te padise dhe pezullimin ekzekutimit te Urdher Nr.41/1 Prot, dt.01/06/2020,"sekuestro te asetëve te debitorit" te nxjerr per efekt te ekzekutimit te titullit ekzekutiv, vendimin gjyqësor Nr.156 date.14/04/2020 te Gjykates Apelit Durres deri ne zgjidhjen e ceshtjes me me vendim gjyqësor te formes se prere.

Nisur sa me siper e zbatim te neneve 527,589,593,vijues te K.Pr.civile dhe ligjit Nr.26/2019 "Per Sherbimin Permbarimit Gjyqësor Privat".

QENDRA KOMBETARE  
E BIZNESIT

## URDHËROHENI

1-Qendra Kombetare Bisnesit Tirane,ne ekzekutim te vendimit gjyqësor Nr.12,dt.08/02/2022 te Gjykares Rret. Gjyqësor Durres,duhet te pezullohet ekzekutimi i Urdher Nr.41/1 Prot, dt.01/06/2020,"sekuestro te asetave te debitorit" te nxjerr per efekt te ekzekutimit te titullit ekzekutiv,vendimin gjyqësor Nr.156 date.14/04/2020 te Gjykares Apelit Durres deri ne zgjidhjen e ceshtjes me vendim gjyqësor te formes se prere.

3- Për veprimet tuaja të njoftoni zyrtarisht brenda afatit ligjor.

4-Personat qe bëhen pengese për zbatimin e këtij urdhri,do te pergjigjen sipas nenit 598 e ne vijim te K.Pr. Civile dhe dispozitave te Kodit Penal.

-Ky urdhër,u njoftohet paleve dhe kane te drejten e ankimit në Gjykatë brenda 5 diteve.

Bashkngjitur ju dergojme fotkopje te vendimit gjyqësor Nr.12,dt.08/02/2022 te Gjykares Rrethit Gjyqësor Durres.

Kopje te Urdher Nr.41/4 Prot,dt.01/06/2020 Zyra Permabimore Best 2010,Saimir Hoxha per Q.K.Bisnesit Tirane

Duke ju falënderuar per bashkpunimin:

PERMBARUESI GJYQESOR

/EDUARD ALLAMANI/





REPubLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Regj. Them: (21274-00299) 1639

Data e regjistrimit: 03.02.2022

Numri i vendimit: 12

Data e vendimit: 08.02.2022

VENDIM

(Shkurtim-Vendimi)

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me trup gjykues të përbërë prej:

**GJYQTAR: Shpëtim Reka**

asistuar nga sekretare gjyqësore Valentina Halilaj, në Durrës, sot më datë **08.02.2022**, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen civile Nr.1639 Regjistri Themeltar që i përket:

**PADITËS:** Shoqëria EMS Albanian Port Operator (EMS APO) SHPK, me seli: Lagjja Nr.13, Porti i Durrësit, Terminali Limdor, Hyrja Nr.5, Durrës.

**E PADITUR:** Zyra Përmbarimore BEST 2010, përmbarues gjyqësor Saimir Hoxha, me adresë: Prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës.

Zyra Përmbarimit Gjyqësor Privat Eduard Allamani, me adresë: Lagjja Nr.2, rruga Aleksandër Goga, Durrës.

**PERSON I TRETË:** Shoqëria Albanian Stevedoring Company SHPK, me seli: Lagjja Nr.1, rruga Tregtare, Porti Detar, pranë Zenës së Mirëmbajtjes Mekanike, Durrës.

**OBJEKTI:**

- 1-Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke "hequr sekuestron konservative pranë QKB të vendosur nga përmbaruesi gjyqësor privat Saimir Hoxha me shkresën 41/4 datë 01.06.2020, në aksionet e Shoqërisë "EMS-Albanian Port Operator (EMS APO) sh.p.k", deri në përfundim të gjykimit.
- 2-Kundërshtimin dhe Anullimin e veprimit përmbarimor të njoftuara me shkresën:  
-Sekuestro të aseteve të debitorit" Nr. 41/4 prot, datë 08.04.2021 drejtuar QKB, të përmbaruesit gjyqësor privat Saimir Hoxha si të kryer në kundërshtim me ligjin, dhe rregullimin e pasojave ligjore.

3. Pagimi i shpenzimeve gjyqësore dhe avokatisë.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 102-110, 610, 615/a të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata pasi u njoh me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të urdhrimit të sekuestros konservative si dhe çmoi aktet bashkëlidhur kërkesëpadisë,



**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 126, 158/a dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse Shoqëria EMS-Albanian Port Operator (EMS APO) SHPK, lidhur me kundërshtimin e veprimit përbarimor, urdhrimit Nr.41/1.Prot., datë 01.06.2020, "Për vënien e sekuestros konservative", të nxjerrë për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimi Nr.156, datë 14.04.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të Zyrës Përbarimore Private BEST 2010, përbarues gjyqësor Saimir Hoxha.
2. Anulimin e veprimit përbarimor urdhrimit Nr.41/1.Prot., datë 01.06.2020, "Për vënien e sekuestros konservative", të nxjerrë për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimi Nr.156, datë 14.04.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të Zyrës Përbarimore Private BEST 2010, përbarues gjyqësor Saimir Hoxha.
3. Pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e ekzekutimit të urdhër Nr.41/1.Prot., datë 01.06.2020, "Sekuestro të Aseteve të Debitorit", të nxjerrë për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimi Nr.156, datë 14.04.2020, i Gjykatës së Apelit Durrës, deri në zgjidhjen e çështjes me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet menjëherë Zyrës Përbarimore Private Best 2010, përbarues Gjyqësor Saimir Hoxha si dhe Zyrës Përbarimit Gjyqësor Eduart Allamani, me qëllim ekzekutimin e vendimit.
5. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet palëve ndërgjyqëse.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**U shpall sot në Durrës, më datë 08.02.2022.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
“ZYRA PERMBARIMIT BEST 2010”

Nr.41/4.prot

Datë, 01 qershor 2020

Lënda: Sekuestro të aseteve të debitorit

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

I nderuar drejtues,

Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket dosjes përmbarimore, në zbatim të vendimit nr.156, datë 14.4.2020 të Gjykatës së Apelit Durrës,

KONSTATOVA:

Se pranë kësaj zyre përmbarimore është depozituar kërkesa e kreditorit për zbatimin e titullit ekzekutiv (vendimit gjyqësor të lartpërmendur) me palë e objekt:

- Kreditor: “Albanian Stevedoring Company” shpk
- Debitor: “EMS Albanian Port Operator” shpk (nuis L31804506A)
- Objekti: Shlyerje të detyrimit monetar dhe dorëzim sendi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se debitori ndër të tjera duhet të përmbushë detyrimin prej (llogaritur deri më sot) prej 31.042.869 lek. Gjithashtu duhet të shlyejë edhe tarifatat/shpenzimet gjyqësore/përmbarimore leke ndaj kreditorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se debitori ende nuk e ka shlyer detyrimin e për pasojë duhet të procedohet me sekuestrimin e pasurive të tij.

Kjo zyrë ka informacion se debitori mban llogari pranë jush, e për shkak të kësaj duhet të bllokohet.

Për sa më lart dhe bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C,

JU URDHËROJ QË:

- 1- Të bllokoni çdo aset/aksione të shoqërisë debitore;
- 2- Ky urdhër qëndron në fuqi deri në një urdhër tjetër të kësaj zyre;
- 3- Për veprimet tuaja na njoftoni brenda afateve ligjore.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

SAIMIR T. HOXHA